



PPP.nr. 1109/2015

~~GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË~~-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Naime Ahmeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve Maliq Krasniqi dhe Leunitë Krasniqi, që të dy nga fshati Lladroviq-Malishevë, kundër debitorit Qeveria e Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore për borxh në vlerë 3,000.00 €, duke vendosur lidhur me propësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e Përmbarimit numër P.nr.715/14 datë 10.10.2014, të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Afet Mjeku nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 11.01.2017, mori këtë:

AKTVENDIM

PRANOHET si i bazuar propësimi i debitorit: Qeveria e Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, dhe ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr. 715/14 datë 10.10.2014, i përmbaruesit Afet Mjeku.

Arsyetim

Përmbaruesi privat në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të Aktvendimit të datës 15.01.2014, të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur propësim, me të cilin konsideron se urdhri për ekzekutim është i parregullt, dhe kërkon nga gjykata ta vërtetoj gjendjen faktike, sepse borxhi është paguar nga skema PPAK-ut për 12 muaj në totalin e shumës prej 720 euro, që do të thotë se kreditori shumë e lartcekur e ka realizuar gjatë vitit 2013, me tej ka theksuar se i njëjti kreditor pas vlerësimit të komisionit mjekësor ka kaluar në skemën e personave të verbër sipas ligjit Nr.04/L-92, ku sipas këtij ligji kompensimi financiar për efekte e verbërisë është 100 dhe diferenca 40 euro, që do të thotë se nuk mundet i njëjti të paguhet dy herë për të njëjtën çështje. Andaj debitori ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet propësimi dhe urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditorët nuk kanë paraqitur përgjigje në propësimin e debitorit.

Kjo gjykatë duke vepruar edhe sipas udhëzimeve të aktvendimit të Gjykatës së Apelit AC.nr.2928/15 të dt.11.11.2015, ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në propësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se propësimi është i bazuar për këto arsye:

Gjykata vlerëson se debitori me aktvendimin e datës 15.01.2014, kreditorëve ua ka njohur kompensimin për të verbër kreditorit Maliq Krasniqi dhe kreditorës Leunitë Krasniqi, i është pranuar kompensimi si shoqëruese e personit të verbër, në shumë prej 720.00 euro, për vitin 2013.

Gjykata vlerëson se aktvendimi nuk është pajisur me vërtetim të plotfuqishmërisë dhe me vërtetim të përmbarueshmërisë, ndërsa përmbaruesi privat para lejimit të

përmbarimit nuk ju ka kërkuar kreditorëve që aktvendimi të pajiset me këto vërtetime dhe nuk ka vërtetuar faktin se cila pjesë e kompensimit është paguar e cila pjesë e kompensimit ka mbetur me u paguar me ekspertë financiar.

Në rastin konkret kjo gjykatë vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e Urdhrit Përmbarimor nga ana e përmbaruesit, sepse aktvendimi i marrë në procedure administrative nuk ka vërtetim për përmbarueshmëri, në kuptim të nenit 36 par.1 të LPP-së, si kundër nuk është vërtetuar se debitori a ka paguar ndonjë shumë të kreditorëve, nëse ka paguar atëherë duhet të vërtetohet se cila pjesë ka mbetur pa paguar. Kështu kjo gjykatë vendosi të anuloi urdhrin përmbarimor duke pranuar prapësimin e debitorit.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të aktvendimit e duke bazuar nenin 73 par.3 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PPP.nr.1109/15, dt.11.01.2017

Gjykatëria
Naim Ahmeti



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.